


PULLE TAKSE




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 4579 Rep.
NR. 3417 Kol.

*Publika e takses
u pagua*

[Signature]



KONTRATE KONCESIONI

E FORMES "BOT" (NDERTIM - OPERIM - TRANSFERIM)
PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "BISHNICA 1" DHE "BISHNICA 2"

Ne Tirane, me date 06, muaji gjetor, viti 2008 (dy mije e tete), u paraqiten para meje notere Muljeta Kompele regjistruar ne Dhomen e Noterise Tirane me adrese A.p. Komit Urasit Nr. 51/1, palet kontraktuese si me poshte:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, qe me poshte do te quhet "AUTORITET KONTRAKTUES", percaktuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Vendimit nr. 214, date 21.02.2008 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per dhenien me koncension te hidrocentralit "Bishnica 2", dhe miratimin e bonusit ne proceduren perzgjedhese konkurruese qe i jepet shoqerise" perfaqesuar me autorizimin nr. 6377/21, date 12.08.2008, nga z. Kristo RODI, i datelindjes: _____ madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi NF

DHE

Bashkimi i perkohshem i shoqerive "TITAN" sh.p.k & "OSMANI" sh.p.k, qe ne vijim do te quhet "KONÇESIONARI", i formuar sipas marrëveshjes nr. 1547 Kol, nr. 1732 Rep, date 08.05.2008 me këto të dhëna:

Shoqëria "TITAN" sh.p.k, me seli ne Tirane, rregjistruar ne QKR, date 06.09.2007, me NIPT K72111004T.

Shoqëria "OSMANI" sh.p.k, me seli ne Gramsh, rregjistruar si person juridik me Vendimin nr.16471, dt. 12.12.1996, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, NIPT J76314808M.

Shoqëria "TITAN" eshte caktuar si perfaqesuese me kompetenca te plota per bashkimin e shoqerive, me ane te Kontrates per Bashkepunim te Perkohshem te Shoqerive Nr.1732 Rep., Nr. 1547 Kol, date 08.05.2008 dhe perfaqësohet nga z. Refat Mustafaraj, i biri i _____, lindur me _____ per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta _____ madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Hyrje

Duke patur parasysh qe:

Qeveria e Shqiperise:

1. I ka dhene nje rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj ose rehabilitimit te hidrocentraleve ekzistuese me ane te procedurave te koncesionit, per permiresimin e treguesve teknike dhe ekonomike te rrjetit elektrik kombetar;
2. Konsideron ndertimin e hidrocentraleve si nje element te rendesishem te politikese se zhvillimit te sektorit te energjise.
3. Vlereson formen "BOT" te koncesionit, si nje forme koncesioni qe ben te mundur stimulimin e investitoreve private per ndertimin e hidrocentraleve te rinj me anen e kapitalit privat;
4. Eshte e angazhuar per krijimin dhe zhvillimin e tregut te brendshem te energjise elektrike brenda vendit;
5. Mirepret investoret vendas ose te huaj ne ndertimin e kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike.



Koncesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, per ndertimin dhe shfrytezimin e hidrocentraleve "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2", si nje propozim i pakerkuar, dhe ne perfundim te procedures perzgjedhese konkurruese eshte vleresuar si ofertuesi me i mire.
2. Eshte i interesuar te investoje ne ndertimin e hidrocentraleve "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2", Komuna Velcan, rrethi Pogradec, me qellimin prodhimin e energjise elektrike dhe rritjen e sigurise te furnizimit me energji elektrike te zones;
3. Bashkimi i perkohshem i shoqerive "TITAN" sh.p.k & "OSMANI" sh.p.k, zoteron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiar, per te realizuar projektin e miratuar sipas objektit te kesaj marreveshje;
4. Zoteron aftesite drejtuese, financiare dhe teknike te kerkuara si dhe aftesite per te plotesuar kete iniciative ne perputhje me standartet nderkombetare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 "Për koncesionet" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 21.02.2008 "Për percaktimin e autoritetit kontraktues per dhenien me koncension te hidrocentralit "Bishnica 2", dhe miratimin e bonusit ne proceduren perzgjedhese konkurruese qe i jepet shoqerise" dhe bien dakort për sa më poshtë:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Perkufizime dhe interpretime

Kudo qe ne kete Marreveshje perdoren termat e meposhteme, ato do te kene kuptimet perkatese si me poshte si vijon :

1. **Kontrata e Koncesionit** : Kjo kontratë, aneksi/aneokset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
2. **Ligji "Për Koncesionet"**: Ligji nr.9663 dt.18.12.2006 "Për koncesionet".



3. **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.
4. **Konçesionari:** Bashkimi i perkohshem i shoqerive "TITAN" sh.p.k me seli ne qytetin e Tiranës, dhe "OSMANI" sh.p.k me seli ne qytetin e Gramshit.
5. **Hidrocentral:** Hidrocentralet "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2", me vendndodhje në Pogradec, me fuqi totale të instaluar 2 950 kW dhe prodhim total të energjisë elektrike rreth 12 910 000 kWh, te përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalën e devijimit, bazenën e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesat e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në to.
6. **Objekti:** Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajta e hidrocentraleve "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2" dhe transferimi i tyre nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues.
7. **Investimi:** Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe paisjen me makineritë e nevojshme të hidrocentraleve, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
8. **Punimet:** Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2",
9. **Fillimi i punimeve:** Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8 pika 2 e kësaj kontrate.
10. **Vënia në punë e hidrocentraleve:** Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.
11. **Kontratat:** Te gjitha kontratat e nenshkruara nga Konçesionari, me sipërmarresit per realizimin e punimeve;
12. **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatëse publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektivit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin shqiptar.
13. **Tarifa konçesionare:** Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.
14. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
15. **Subjekti i furnizimit me energji elektrike:** Personi i liçencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar.
16. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Konçesionari.

Neni 2

Objekti i Konçesionit

Objekti i kesaj kontrate konçesionari është :
Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve te kesaj kontrate.

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit "Për konçesionet", i jep Konçesionarit me konçesion të formës BOT (qe do te thote: Ndertim, operim dhe transferim i te drejtes se pronesisë dhe operimit ne perfundim te kontrates se konçesionit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve te kesaj kontrate):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajten e hidrocentraleve "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2" dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3

Karakteristikat e hidrocentraleve "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2"

Hidrocentralet "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2" do të ndërtohet rrjedhën e perroit të Bishnices, në rrethin e Pogradecit, me këto karakteristika:

HEC-i "Bishnica 1"

- Kuotat e veprave
 - o Kuota e vepres se marrjes 1 129 m
 - o Kuota e godines se centralit 1 033 m
- Prurja llogaritëse 0.59 m³/s
- Fuqia e Instaluar 450 kW
- Prodhimi i energjisë elektrike 1 790 000 kWh

HEC-i "Bishnica 2"

- Kuotat e veprave
 - o Kuota e vepres se marrjes 1 030 m
 - o Kuota e godines se centralit 665 m
- Prurja llogaritëse 0.85 m³/s
- Fuqia e Instaluar 2 500 kW
- Prodhimi i energjisë elektrike 11 120 000 kWh


Neni 4

Kohëzgjatja e Kontratës së Konçesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Konçesionarit me konçesion ndërtimin e hidrocentraleve "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2" për një periudhë 35 (tridhjetepese) vjeçare.

Një vit para përfundimit të kësaj periudhe, palët me vullnet të përbashkët mund të zgjasin afatin e kësaj kontrate, kur vlerësohet se, nga ana e Konçesionarit janë përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.

Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj Kontrate.



KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Pronësia dhe dorëzimi i aseteve të projektit

1. Titulli i pronësisë

E drejta e pronësisë mbi asetet pronë shtetërore që do t'i shërbejnë objektit të kontratës së konçesionit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, i mbetet Autoritetit Kontraktues.

Neni 6

Monitorimi dhe Mbikqyrja e Përgjithshme

1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në çdo kohë, gjatë periudhës së konçesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e konçesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

2. Mbikqyrja e përgjithshme

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë një mbikqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë mbikqyrjes së përgjithshme, Konçesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të sigurojë vazhdimësinë e kontratës pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtar dhe të sektorit.
2. Të ndihmojë Konçesionarin pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur eshte e nevojshme për marrjen e licencave ose lejeve që do t'i shërbejnë për ekzekutimin e punimeve dhe implementimin e kësaj kontrate.
3. Të miratojë projektin e Zbatimit të hidrocentraleve, të përgatitur nga vete Konçesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës. Koha e nevojshme për miratimin e projektit nuk ben pjese në grafikun e punimeve të parashikuara në Aneksin nr.2 bashkelidhur.
4. Të ndihmojë Konçesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
5. Të garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga subjekti i furnizimit të energjisë elektrike, për 15 (pesëmbëdhjete) vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike.

6. Të garantojë Konçesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike në të njëjtën rrjedhë, nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e hidrocentraleve “Bishnica 1” dhe “Bishnica 2”.

KREU III

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONÇESIONARIT

Neni 8

Detyrimet e Konçesionarit

Konçesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Konçesionari duhet që:

1. Të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Konçesionit, shoqërinë konçesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj vetëm financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajten e hidrocentraleve dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës tek Autoriteti Kontraktues. Shoqëria e krijuar do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.
2. Te paraqese prane Autoritetit Kontraktues, per miratim projektin e zbatimit, brenda 6 (gjashte) muajve nga dita e hyrjes ne fuqi te kesaj kontrate.
3. Te marre te gjitha lejet dhe licensat e nevojshme per realizimin e kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontratës;
5. Të marrë masa me qëllim që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
6. Të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentraleve “Bishnica 1” dhe “Bishnica 2” me fuqi të vendosur jo më pak se per te dy hidrocentralet 2950 kW;
7. Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;
8. Të shesë të gjithë prodhimin e energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të paktën për 15 (pesëmbëdhjete) vitet e para te prodhimit.
9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta;
10. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjenës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar;
13. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.



Neni 9

Vleresimi i Investimeve

Mbi bazen e te dhenave te projektit, investimet qe duhet te kryhen nga konçesionari jane ne vleren totale prej 250 000 000 (dyqindepesdhjetemilion) lekesh, nga te cilat 59 999 900 (pesedhjetenentemilion nenteqindenentehjetenentemije e nenteqind) leke do te investohen ne makineri e pajisje, sipas listes se paraqitur nga ofertuesi ne proceduren konkuruese.

Vleresimi i mesiperim mund te pesoje ndryshime te mundshme, me marreveshje ndermjet paleve:

- pas variantit perfundimtar te projektzbatimit
- ne çdo kohe gjate zbatimit te projektit ne ndertimin e vepres, sipas efektivitetit te ofertave

Vlera e ndryshuar e investimit mund te jete me e madhe se 250 000 000 (dyqindepesdhjetemilion) leke, por jo me e vogel se 237 500 000 (dyqindetridhjeteeshtatemilion e peseqindmije) leke, qe perfaqeson nje ndryshim te investimit ne vleren 5 % te investimit total te parashikuar.

Neni 10

Programi punimeve

Konçesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

1. Konçesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 (tridhjete) ditësh nga data e miratimit të lejes se ndertimit.
2. Konçesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralet brenda 15 (pesembedhjete) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit 2 bashkëlidhur.
3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt proceduriale për marrjen e tyre.
4. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonesave të krijuara nga subjektet shtetërore.

Neni 11

Testimi i veprës

Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i paisjeve, për të siguruar funksionalitetin e hidrocentraleve.

Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Konçesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentraleve.

Neni 12

Zgjidhja e Kontratës së Konçesionit

1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

- Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhe Kontratën e Konçesionit në mënyrë të njëanëshme, pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër:



1. Kur Konçesionari nuk fillon punën për 6 (gjashte) muaj nga data e miratimit të projektit të zbatimit;
2. Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektit të propozuar nga Konçesionari; te percaktuar ne nenin 3 te kesaj kontrate.
3. Kur Konçesionari transferon aksionet/kuotat, pa miratim të Autoritetit Kontraktues.
4. Kur Konçesionari nuk jep përgjigje të argumentuar për shkeljen, brenda afatit 30(tridhjete) ditor të parashikuar në nenin 24 të kësaj kontrate.

Në rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 1 e këtij neni), ai ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës.

2. Zgjidhja e kontratës nga secila palë.

- Secila palë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër, kur:

- a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar me marrëveshje mes tyre.

3. Zgjidhja e kontratës me konsensus

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e konçesionit me pëlqim të dyanshëm.

Në rastet e zgjidhjes së njëanshme të kontratës nga secila palë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e hidrocentraleve, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Konçesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e kontratës deri në momentin e dorëzimit të hidrocentraleve te Autoriteti Kontraktues.

Neni 13 Kontratat

Konçesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontrate tjetër, me qëllim realizimin e objektit të konçesionit.

Në të gjitha kontratat, Konçesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate konçesioni.

Përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Konçesionari.

Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Konçesionarit.

Neni 14

Sigurimi i kontratës

Konçesionari, para firmosjes së kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 25 000 000 (njetzetepesemilion) lekë, qe perben 10 % të vlerës totale të investimit.

Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkelidhet kësaj kontrate.

Konçesionarit i lejohet të ç'ngurtësoje këtë vlerë vetëm pasi të ketë kryer investimin e plotë dhe të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga realizimi i investimit, kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë e saj.

Neni 15

Sigurimet

Konçesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë fazës së shfrytëzimit, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Konçesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij cdo vit.

Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë shfrytëzimit të objektit vlera e dëmit të kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit.

Konçesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjesie jo më të ulët se 200 000 (dyqindmije) Euro për cdo ngjarje dhe 500 000 (peseqindmije) Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jete me e larte se 1000 (njemije) Euro për cdo ngjarje dhe 2000 (dymije) Euro në vit.

Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 16

Tarifa konçesionare dhe vlera e riinvestimit

1. Tarifa konçesionare

Konçesionari duhet të paguaje për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë konçesionare të barabartë me vlerën e 2 % të energjisë elektrike të prodhuar në një vit. Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së konçesionit.

2. Vlera e riinvestimit

Çdo 15 (pesëmbëdhjetë) vjet Konçesionari do të riinvestojë 40 % të vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet.

Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 17
Kufizimet/Lejime

Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Koncesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.

Koncesionari nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë, përveç se kur nje transferim i tillë miratohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

Shoqeria e re që do të krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose Koncesionari ka të drejtë të vendosi hipoteke, peng, apo ndonje barre tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve se dhe të lidhe cdo lloj marrëveshje financimi me cdo Pale Financuese, me kusht që hipoteka, peng apo barra tjetër si dhe marrëveshja perkatese e financimit t'i shërbeje përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit në këtë Kontratë.

Neni 18
Raportimi

Koncesionari është i detyruar që çdo tre muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19
Legjislacioni i zbatueshem

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Konçesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 20
Forca Madhore

Konsiderohen ngjarje të Forcës Madhore, katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin për faj të tyre, dhe që ndikojnë në objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të palëve .

Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 15 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose pezullimin e tyre, në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

Në rast se kontrata do të zgjidhet për shkak të forcës madhore asnjë palë nuk do të mbajë përgjegjësi ndaj palës tjetër për kostot apo dëmet që rrjedhin nga mospërmbushja e Kontratës.

Neni 21

Hyrja ne fuqi e Kontrates se Konçesionit

Kontrata e Konçesionit do te hyje ne fuqi mbasi te jete miratuar nga Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me Ligjin Nr.9663, date 18.12.2006 "Per konçensionet".


Neni 22

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Konçesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Konçesioni, do të jetë Gjykata e Arbitrazhit.

Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.



Neni 23

Sanksionet

1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës 15 (pesëmbëdhjete) mujore të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Konçesionarin si më poshtë:

- a. Për shkelje të afatit të ndërtimit 0,05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara.
- b. Për moskryerje ne total të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurim, Konçesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të perealizuara.
- c. Për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 (dhjetemije) lekë.

2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakort me këtë kontratë, penalizon Konçesionarin si më poshtë:

- a. Në rast mosrealizimi, për faj të Konçesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 12 910 000 KWh/vit, Konçesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese.
- b. Për mosrealizim deri në 10 % të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar, Konçesionari do të penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.

3. Mosparaqitja ne kohe e Projektit te Zbatimit per miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar ne nenin 8, pika 2 te kesaj kontrate koncesionare, e penalizon Koncesionarin me 0,005% te vleres se investimit.

Sanksionet paguhen ne llogari te Autoritetit Kontraktues.

Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 (tridhjetë) ditore lidhur me shkeljen.

Pas përfundimit të kësaj periudhe, kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 10 (dhjete) ditësh.

Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohe, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

Neni 24 Rregullimi i shkeljeve

Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së konçesionit, Konçesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Konçesionarit duke pritur për një periudhë 30 (tridhjetë) ditore përgjigjen e tij me argumentat përkatëse.

Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

Kjo procedurë nuk e zhvesh Konçesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.

Neni 25 Transferimi i Aseteve

Me mbarimin e Kontratës së Konçesionit si rezultat i përfundimit të afatit të zakonshëm ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e Konçesionit, përfshirë edhe çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Konçesionari në kantierin e Konçesionit, duhet t'i transferohen Autoritetit Kontraktues.

Transferimi do të përfshijë por pa u kufizuar në to:

- Dorëzimin fizik të asetëve.
- Dorëzimin e dokumentave që shoqërojnë këto asete.
- Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me këto asete.
- Kalimin e titullit të pronësisë për ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga Konçesionari.

Konçesionari duhet të garantojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune.

Neni 30
Rregjistrimi i kësaj kontrate

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të rregjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Përfaqësuar me Autorizimin Nr.6377/21,
datë 12.08.2008, të Ministrit të Ekonomisë,

Tregtisë dhe Energjetikës

Nga Z. Kristo RRODI

KONCESIONARI

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive
"TITAN" sh.p.k. & "OSMANI" sh.p.k.

Përfaqësuar

Nga Z. Refat Mustafarai